PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË THELLUAR TË VNM-SË

AKTIVITETI:

FABRIKË E RICIKLIMIT TË BATERIVE TË PLUMBIT, XEHERORËVE ME PËRMBAJTJE TË PLUMBIT DHE PRODHIMIN E ALIAZHEVE TË NDRYSHME TË PLUMBIT.

VENDNDODHJA:

Ish Kombinati Metaluargjik Elbasan, Reparti i derdhjes së gizës (objekti 45) ndërmarrja e seleksionimit të metaleve



Shtojca I: Pika 4.b.v, 9 dhe Shtojca II: Pika 4 ç

INVESTITOR: CCALB Sh.p.k

Hartoi Raportin e Vlersimit t Ndikimit në Mjedis

LORENCO & CO

Tiranë, 2018

Lorenco & CO. sh.p.k. 1996
Mapping & GIS, Planning, Designing, Engineering
e-mail: info@lorenco.co

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. **HYRJE**

2. **INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM & METODIKË E ZBATUAR**

3. **PËSHKRIMI I PROJEKTIT**

4. **PËRSHKRIMI I ANALIZIMIT TË ALTERNATIVAVE TË MUNDSHME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT**

5. **PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT**

6. **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS**

7. **NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT**

8. **NDIKIMET POZITIVE NË MJEDISIN E ZONËS SË PROJEKTIT**

9. **MASAT E PROPOZUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

10. **PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT**

11. **PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR**

12. **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

1. HYRJE

Ligji i Vlerësimit të ndikimit mjedisor nr. 10 440 datë 07.07.2011 mbi ''Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor''i ndryshuar, në Shqipëri thekson për përgatitjen e vlerësimeve mjedisore të çdo projekti të zhvillimit që mund të shkaktojnë ndikime në mjedisin e vendit.

Ky raport VNM-je është përgatitur sipas kërkesave kombëtare të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit të përmendura me poshtë si dhe sipas legjislacionit të BE-së marrë si referencë. Legjislacioni Kombëtar i Shqipërisë përcakton rregullat dhe mënyrat për kryerjen e një VNM-je të kësaj natyre, të cilat konsulentët i kanë konfirmuar. Ligji ka theksuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe burimet e tij duke e konsideruar atë si pjesë e trashëgimisë kombëtare e cila duhet të ruhet dhe të mbrohet për të mirën e gjeneratave të ardhshme. Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve të tij është një pararendës kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Ky raport VNM-je do të identifikojë ndikimet e mundshme në mjedis të punimeve të propozuara për Restaurimin e objektit ekzistues dhe montimin e fabrikës së riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit, me theks të veçantë në rekomandimet mbi zvogëlimin e ndikimit dhe marrjen e masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe funksionimit të tij. Raporti i thelluar i VNM-së do të diskutojë gjithashtu mbi justifikueshmerine e projektit, alternativat e vendosjes së komponentëve të projektit të tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë zbatimit dhe pas përfundimit të punimeve të propozuara, si dhe gjatë funksionimit të instalimit.

Raporti i thelluar i vlerësimit te ndikimit ne mjedis merr ne konsiderate zonën e përzgjedhur për zhvillimin e aktivitetit, planet e propozuara per zhvillimin e zones se Kombinatit Metalurgjik Elbasan, kushtet klimaterike dhe hidrologjike te zones.

Raporti i Thelluar i VNM-se është përpiluar bazuar në të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura nga ekspertët e kontraktuar të cilët gjatë inspektimeve në terren dhe vlerësimeve të kryera në muajt Tetor 2017 – Dhjetor 2017. Megjithatë, vlerësime të bëra nga konsulentë të ndryshem në vitet e mëparshme janë shfrytëzuar gjatë përgatitjes së raportit. Të dhënat afatgjata mbi disa aspekte të tilla si meteorologjia, sizmiciteti zonës, të dhënat gjeomorfollogjike dhe klima janë mbledhur nga nga hetimet dhe studimet e realizuara nga shoqeria Vlerësuese LORENZO & CO, si dhe nga burime dytësore përmes raporteve të publikuara më parë dhe të databazave globale.

Gjithashtu objekt i këtij studimi eshte dhe për të përcaktuar karakteristikat e strukturës si dhe të materialeve si psh cilësia e betoneve (klasat dhe përbërjet granulometrike), të armatures si dhe tipologjite konstruktive të soletave dhe themeleve. E njëjta studio ka kryer edhe sondazhet gjeologjike për të përcaktuar karakteristikat stratigrafike të terrenit ku do të zhvillohet projekti Restaurimin e objektit ekzistues dhe montimin e fabrikës së riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit.

2. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM & METODIKËN E ZBATUAR

Gjëndja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij, janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerezimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqerohet me rritje të vazhdueshme të numërit të ndërmarjeve operuese, ndertimin e objekteve te reja, lidhjet infrastrukturore, etj e si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapsira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe tokë, biodiversitet flore dhe faune.

Planifikimi urban si një veprimtari komplekse, natyrore, inxhinjerike, klimatike, biologjike, sociale dhe legjislative e shoqerisë njerezore të civilizuar, mbështetet në radhë të parë mbi mjedisin gjeologjik dhe ekosistemet e lidhur me të.

Ai ka dy aspekte veprimtarish:

- Së pari, ndryshimet që njeriu i bën gjeomjedisit dhe ekosistemeve për ti pershtatur ato me kërkesat e tij jetësore, sipas filozofise "njeriu e ndryshon natyren" për të përmirësuar jetesën e tij.
- Së dyti, impaktet e këtyre ndryshimeve mbi vetë mjedisin gjeologjik si dhe mbi jetën e njerëzve.

Qëllimi i këtij dokumenti bazohet në restaruimin e "Repartit te derdhjes se gizes (objekti 45) ndermarrja e seleksionimit te metaleve" me vendndodhje ne ish Kombinatin Metaluargjik Elbasan (marre me qera Nr. 3220 Rep. Nr. 1252 Kol, me date 13.07.2017 nga Keshilli i Qarkut Elbasan me afat 20 vjecar dhe pershtatja e ketij objekti me siperfaqe ndertese 1568 m^2 per Fabriken e Riciklimit te Baterive te Plumbit, xeheroreve me permbajtje te plumbit dhe prodhimin e aliazheve te ndryshme te plumbit.
Projekti arkitektonik dhe inxhinierik per Restaurimin e objektit ekzistues dhe montimin e Fabriken e Riciklimit te Baterive te Plumbit, xeheroreve me permbajtje te plumbit dhe prodhimin e aliazheve te ndryshme te plumbit eshte projektuar ne menyre te tille qe te respektoje distancen nga kufiri i pronesise, distancen nga objektet industriale, respektimin e koeficentit te ndertimit dhe hapsirave te gjelberta, si dhe impakte minimale ne mjedisin e zones ku do te zhvillohet projekti.

2.1 PËRSHKRIMI I QËLLIMIT DHE OBJEKTIVAVE TË VNM-SË

Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Restaurimin e objektit ekzistues dhe montimin e fabrikës së riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
Qëllimi i këtij raporti VNM është të vlerësojë impaktet potenciale sociale dhe mjedisore nga implementimi i këtij projekti, të rekomandojë masat zbutëse për minimizimin e impakteve

potenciale të vlerësuara, si gjatë fazës së implementimit të projektit ashtu dhe në fazën e funksionimit, duke synuar qëllimin final mbrojtjen e cilësisë së mjedisit dhe shendetit te njerezeve perreth zones qe zhvillohet.

Qëllimi i impiantit është të ricikloje baterite e përdorura të makinave apo përpunojë koncentratin e plumbit në mënyrë që të mund të ripërdoret apo përdoret në formën e lëndës së parë për produktin e ri.

Investitori "CCALB" Sh.p.k ka marrë me qera Nr. 3220 Rep, Nr. 1252 Kol, me date 13.07.2017 nga Keshilli i Qarkut Elbasan, objektin "Repartit te derdhjes se gizes (objekti 45) ndermarrja e seleksionimit te metaleve" me vendndodhje ne ish Kombinatin Metaluargjik Elbasan me sipërfaqe totale 5123 m2 me sipërfaqe truall funksional 3555 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 1568 m2, me qëllim përshtatjen e saj për Fabriken e Riciklimit te Baterive te Plumbit, xeheroreve me permbajtje te plumbit dhe prodhimin e aliazheve te ndryshme te plumbit.

Planvendosja e Objektit sipas Formatit Grauss Kruger zone 4

Koordinatat e Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit sipas sistemit Koordinativ GAUS KRUGER		
Nr.	X	Y
1	4551293.22	4417944.61
2	4551300.87	4417961.08
3	4551293.69	4417964.08
4	4551292.06	4417960.42
5	4551265.87	4417972.44
6	4551270.09	4417983.27
7	4551251.79	4417992.17
8	4551223.21	4417932.19
9	4551241.64	4417924.14
10	4551261.06	4417964.83
11	4551287.66	4417952.67
12	4551285.48	4417948.03

Planvendosja e objektit në ortofoto

2.2 PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.
Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i degradimit mjedisor të vendit gjatë zhvillimit industrial që mori vendi në vitet 50-të. Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë 2000 – 2009, si dhë në disa ligje e VKM të miratuara më vonë se këto vite.

Investitori "CCALB" Sh.p.k pasi eshte pajisur me dokumentacionin e plotë në lidhje me pronësinë ku është projektuar të realizohen ndërhyrjet për Restaurimin e objektit ekzistues dhe montimin e fabrikës së riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit, është shprehur i gatshem për nisjen e nënkontraktimit më një studio mjedisore për marrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit në veçanti, për vet ndjeshmërinë, që ka dhe mund të ketë implementimi i këtij projekti në komunitet dhe mjedisin e zonës përreth.

Hartimi i këtij raporti VNM-je është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011,"Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ku sipas nenit 9 të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës I i nënshtrohen Proçedurës se Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
Gjithashtu hartimi i këtij raporti te thelluar të vlërësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" te ndryshuar, i cili është përafruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Hapat e ndjekura për përgatitjen e raportit nga Studio Mjedisore janë bazuar në VKM nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

2.3 PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket përmendim:

Legjislacioni mjedisor

Baza Ligjore	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji nr. 12/2015, date 26.2.2015	Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në

	Mjedis".
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.81, date 04.05.2017	Për zonat e mbrojtura
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 datë 08.04.2004
Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor", I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë 23.07.2007
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhornuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Ligji Nr. 7643, 09.12.1999 I ndryshuar	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror
Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005	Për efiçencën e energjisë
Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta I ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Vendime të Këshillit të Ministrave	
V.K.M Nr. 686, date 29.7.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së vendimit e deklaratës mjedisore.
V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006	"Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor

	dhe mjedisor
VKM Nr.123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr.247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore
VKM Nr. 575, datë 24.6.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005	Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve
VKM Nr.114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
VKM Nr. 419, datë 26.6.2014	Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.

2.4 PËRSHKRIM TË METODIKËS TË ZBATUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË THELLUAR TË VNM-SË

Metodologjia e VNM-së i referohet çështjeve mjedisore të sugjeruara nga objektivat e parashtruara në Kushtet e Referencës. Raporti i Mjedisit është pergatitur siç detajohet në ligjin përkatës. Për më tepër, raporti rrespekton edhe legjislacionin e BE dhe sigurisht atë Shqipëtar, siç kërkohet. Raporti është përgatitur në bazë të metodave shkencore të themeluara dhe pranuara gjerësisht të cilat përdoren për përgatitjen e vlerësimeve të tilla.

Metodat e mbledhjes së të dhënave janë të përshkruara në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti. Të dhënat janë mbledhur kryesisht nga inpektimet në terren në zonën e zhvillimit të projektit nga Tetor 2017 deri në Dhjetor 2017 nga një ekip inpektorësh dhe eksperti i mjedisit në bashkpunim me studion mjedisore LORENZO & CO Sh.p.k. Megjithatë, të dhëna të publikuara më parë dhe literatura në dispozicion nga projekte të ngjashme janë referencuar gjatë përgatitjes së këtij rapoti të VNM-së.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, u orientua nga rëndësia e veçantë që paraqet Ristrukturimi i objektit ekzistues dhe montimi i fabrikës së riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit, me qëllim konsolidimin strukturor dhe përshtatjen sizmike të godinave si dhe realizimin e ndërtesave me lidhje të fortë funksionale, gjithashtu janë marre në konsideratë edhe pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm. Ne hartimin e raportit te thelluar te VNM-se nje kujdes i vecante studimi eshte dhe ndikimi i projektit ne infrastrukturen ekzistuese te zones.

Autore te Hartimit te Raportit te Thelluar te VNM-se eshte:

- **Studio "LORENZO & CO" Sh.p.k me Nr. NIPTI J61903071B me adrese Rruga "Dritan Hoxha", Pallati i Ri 8-katesh, perballe Procredit Bank, Tirane**

Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit

2.5 METODIKAT E ZBATUARA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT

Metodika e zbatuar për përpilimin e strukturës së raportit të VNM-së është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Hapat e ndjekur për hartimin e raportit të VNM-së:

Hapi 1	Njohja me projektin teknik
Hapi 2	Konsultimi me kuádrin ligjor
Hapi 3	Rishikim i gjendjes aktuale mjedisore, për të evidentuar ndryshimet e mundshme, evulimet apo përmirësimet e saj nëpërmjet inspektimeve në terren
Hapi 4	Evidentimi i impakteve negative të mundshme gjatë zhvillimit të projektit

Hapi 5	Evidentimi i impakteve kumulative të mundshme nga aktivitetet e tjera që kryhen aktualisht në rajonin e projektit
Hapi 6	Hartimi i masave për zbutjen e impakteve në mjedis dhe monitorimin në mjedis
Hapi 7	Konsultimet dhe përfshirja e aktorëve dhe gjithë grupeve të interesit.

3 PËSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 PËRSHKRIMIN E QËLLIMIT TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR;

Projekti i propozuar nga shoqeria CCALB Sh.p.k eshte restaruimi i "Repartit te derdhjes se gizes (objekti 45) ndermarrja e seleksionimit te metaleve" me vendndodhje ne ish Kombinatin Metaluargjik Elbasan (marre me qera Nr. 3220 Rep. Nr. 1252 Kol, me date 13.07.2017 nga Keshilli i Qarkut Elbasan me afat 20 vjecar dhe pershtatja e ketij objekti me siperfaqe ndertese 1568 m^2 per Fabriken e Riciklimit te Baterive te Plumbit, xeheroreve me permbajtje te plumbit dhe prodhimin e aliazheve te ndryshme te plumbit.

Qëllimi i impiantit është të ricikloje baterite e përdorura të makinave apo përpunojë koncentratin e plumbit në mënyrë që të mund të ripërdoret apo përdoret në formën e lëndës së parë për produktin e ri.

Plumbi është metal i riciklueshëm dhe në përgjithësi përdoret për të bërë një bateri të re ose në aplikime të tjera. Në mënyrë që të riciklojmë, ne duhet së pari të veçojmë baterinë në pjesë dhe pastaj ta bëjmë gati ta përdorur përsëri. Bateria e përdorur së pari pritet dhe pjesët e saj nxirren jashtë, më vonë plumbi i nxjerrë dërgohet në furre për shkrirje dhe pasi plumbi është rikuperuar, është rafinuar deri në 99.9% për t'u ripërdorur. Pjesa e dytë e plumbit që mbetet është përsëri metal me përqindje më të ulët, ky plumb mund të përdoret për aplikacione si polet e baterisë etj ose mund të rishkrihet përsëri për tu pasuruar.

Fabrika është projektuar në një mënyrë të tillë që të gjitha përbërësit e baterive të plumbit të harxhuar të riciklohen në një mënyrë në mënyrë që ato të mund të ripërdoren plotësisht dhe të ketë një sasi minimale si mbetje (skrap). Ajo ka gjithashtu fleksibilitet në rikuperimin e plumbit nga xeherori. Kjo fabrikë gjithashtu mund të prodhojë lidhje (aliazhe) të ndryshme të plumbit sipas specifikimeve të klientit.

3.2 PLANIMETRINË E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU TË PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGE, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË;


PLANVENDOSJA E SHESHIT TE NDERTIMIT PER OBJEKTIN
REPARTI I DERDHJES SE GIZES (Objekti 45)
NDERRMARJA E SELEKSIONIMIT TE METALEVE
KOMBINATI METALURGJIK, ELBASAN, PER DHENIE ME QERA
SKEMA RAJONALE SH 1 : 1000
PLANVENDOSJA SH 1 : 500
PER NDERRMARJEN E SELEKSIONIMIT TE METALEVE
DREJTORI
ILIR MEHMETI
PLANVENDOSJE
KURTALI LLOZANA
SOKOL LERNA

Koordinatat e Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit

Koordinatat e Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit sipas sistemit Koordinativ GAUS KRUGER		
Nr.	X	Y
1	4551293.22	4417944.61
2	4551300.87	4417961.08
3	4551293.69	4417964.08
4	4551292.06	4417960.42
5	4551265.87	4417972.44
6	4551270.09	4417983.27
7	4551251.79	4417992.17
8	4551223.21	4417932.19
9	4551241.64	4417924.14
10	4551261.06	4417964.83
11	4551287.66	4417952.67
12	4551285.48	4417948.03

Foto te Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit, Kombinatit Metalurgjik Elbasan

Objekti ku do te zhvillohet aktiviteti per riciklimin e baterive te plumbit eshte ekzistues dhe eshte marre me qira nga Keshilli i Qarkut Elbasan, sipas kontrates se qirase Nr. 3220 rep, Nr. 1252 Kol, me date 13.07.2017 ndermjet Keshillit te Qarkut Elbasan dhe shoqerise CCALB Sh.p.k per pasunine e paluajtshme e cilesuar "Reparti i derdhjes se Gizes Objekti 45" me siperfaqe 5123 m^2, nga e cila siperfaqe truall funksional 3555 m^2, siperfaqe ndertese 1568 m^2, me vendndodhje Kombinati Metalurgjik Elbasan, me afat te dhenies me qira 20 vjevar, nga data 13.07.2017 deri me 13.07.2037 .

Objekti i repartit te derdhjes se gizes do te restaurohet dhe do te pershtatet per instalim e Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit, xeherorit te plumbit dhe prodhimin e aliazheve te plumbit. Nderhyrja ne objekt eshte e domosdoshme pasi ish reparti i derdhjes se gizes eshte i amortizuar gjate viteve te tranzicionit dhe post viteve 90-te nuk eshte vendosur me ne funksionim, makinerite jane te amortizuara dhe te cmontuara pjeserisht, duke patur nje infrastrukture te demtuar dhe jashte funksionimit. Gjithashtu nderhyrjet ne objekt jane te nevojshme pasi linja per riciklimin e baterive te plumbit kerkon nje infrasrukture dhe hapesira sipas standarteve per funksionim optimal te instalimit.

Punimet per restaurimin e objektit dhe instalimin e linjes se riciklimit do te kene nje shtrirje kohore prej 6 muaj, ndersa funksionimi i linjes se riciklimit perllogaritet per nje afat kohor per jo me pak se 20 vite.

3.3 INFORMACIONIN PËR QENDRAT E BANUARA NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA

VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHET PROJEKTI;

Objekti i marre me qera nga shoqeria CCALB Sh.p.k per instalimin e Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit, ndodhet ne Kombinatin Metalurgjik Elbasan.

Zona ne fjale eshte zone industriale e miratuar, dhe ne brendesi te saj nuk ndodhen zona te banuara. Ne brendesi te zones industriale Kombinati Metalurgjik Elbasan, ushtrojne aktivitetin e tyre industrial shume subjekte te karakterit te industrise se shkrirjes se metaleve te skrapit, xeherorit te hekur-nikelit, ferro-kromit, pirolizes se gomave, shperndarjes se karburanteve, etj, pra destinacioni i zones eshte teresisht me karakter industrial.

Ne distance te konsiderueshme nga objekti ku do te zhvillohet aktiviteti ndodhen disa objekte banimi, te cilat jane ndertuar ne menyre informale pas viteve 90-te.



Distanca nga zonat e banuara

Ne afersi te Fabrikes se Riciklimit te Baterive te Plumbit nuk kemi rrjet te transmetimit te tensionit te larte, tubacione e ujesjellesit, shkolla, argjinatura dhe vepra te artit, te cilat mund te demtohen nga projekti i restaurimit te objektit dhe funskionimit te fabrikes. Destinacioni i zones eshte teresisht industrial.

Fabrika per riciklimin e baterive te plumbit ndodhet ne Njesine Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, ne territorin e Kombinatit Metaluargjik.



Vendndodhja e Fabrikës së Riciklimit të Baterive të Plumbit

3.4 SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE TË PROJEKTIT DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT;




Chimney Platform
ID Blower
Scrubber Unit
Bag House For Kettle
Bag House Sets For Rotary Furnace
Refining Kettle
Lead Ingot Movement By FORK LIFT
Finished Goods Storage
Lead Ingots
Gas Cooling Line
Cyclone
Duct Pipeline
Secondary Air Pollution Control Plant For Kettle
Laboratory For Testing Material & Slag
Chemicals & Consumable Store Room
Material Shifting For Refining
Exit For Slag
Rotary Furnace With OverHead Flue Suction
Auto Loader For Rotary
Office Block
ETP Plant
Battery Plates Storage Area
Acid Draining Attachment
Battery Cutting Section
RAW MATERIAL STORAGE
SCRAP PLASTIC STORAGE
Entry Gate
LAYOUT 2ND


Chimney Platform
ID Blower
Scrubber Unit
Bag House For Kettle
Bag House Sets For Rotary Furnace
Gas Cooling Line
Refining Kettle Base
2060mm x 2060mm Made on Ground it has to bear 20MT
1220mm
DUST SETTLING ROOM
4575 mm
2235mm
4575mm
4000mm
2700mm
Gap in both Walls
600mm
2235mm Away From Side Wall
31110mm OR 3111cm Away From Front Wall
ROTARY FOUNDATION
Room of 15' x 15' x 15' 9" Brick Wall From Ground Level, 27" Base Wall from Hard Ground Level
LXWXH
ETP Plant
Finished Goods Storage Lead Ingots
Finished Goods Storage Lead Ingots
Laboratory For Testing Material & Slag
Chemicals & Consumable Store Room
Chemicals & Consumable Store Room
Office Block
Entry Gate
15'4"
18'1"
15'
212'7"
39'3"
LAYOUT 2ND



1) ROTARY BASE CIVIL FOUNDATION DRAWING

OVERALL SIZE: LXBXH [IN MM] 4000 X 2700 X 500 [IN MM]

POINTS TO BE CONSIDERED

1) THIS CIVIL FOUNDATION TO BE LAYED AT HARD LAND. IN INDIA IN OUR AREA. IT IS AT BELOW 5FEET GROUND LEVEL. YOU SHOULD TAKE INTO THIS CONSIDERATION AS PER YOUR PLACE.

2) LINE BLOCK SHOWN "GL" IS GROUND LEVEL. THE TOP LEVEL IS ABOVE 500MM FROM GROUND LEVEL.

3) FOUNDATION BOLT OF 30MM DIAMETER. 4 INCH THREADING SHOULD BE ON ABOVE TOP LEVEL



POINTS TO BE CONSIDERED
1) EACH PILLAR HAS 8 NO. OF FOUNDATION BOLT OF 30MM SIZE EACH
2) 4INCH THREAD SHOULD BE ABOVE FOUNDATION TOP LEVEL
4) ALL THE DIMENSIONS ARE FROM CENTER TO EVERY FOUNDATION BOLT

Foto të proceseve teknologjike

3.5 PËRSHKRIMIN E PROCESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE /PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT;

Investimet qe do te zhvillohen nga shoqeria CCALB Sh.p.k ndahen ne dy faza:

Faza e pare: konsiston ne restaurimin e objektit te fonderise se derdhjes se gizese.

Faza e dyte: konsiston ne instalimin e impianteve te cilat do te sherbejne per riciklimin e baterive te plumbit, xeherorit me permbajtje plumbi dhe prodhimin e aliazheve te plumbit.

Konkretisht ne fazen e pare do te kemi punime te heqjes se suvatimeve te brendshme dhe te jashtme, vendosja e suvatimeve te reja, ndertimi i rrjetit te brendshem te furnizimit me energji elektrike dhe me uje teknologjik, nderrimit te dyerve dhe dritateve, nivelimin e dyshemese dhe izolimin e tabanit te objektit, ndertimin e bazamentit te makinerive dhe instalimeve, krijimi i hapsirave te brendshme te zyrave, laboratorit, magazines, etj. Ndertimi i platformes dhe bazamentit te jashtem te linjes teknologjike, konkretisht per linjen e kapjes dhe trajtimit te gazrave dhe ujrave teknologjike qe do te gjenerohen gjate funksionimit te impiantit. Punime te sistemimit te territorit te jashtem ne funksion te fabrikes se riciklimit te baterive.

Ndersa gjate fazes se instalimit te makinerive do te kemi procese vetem procese te montimit te linjes teknologjike te Fabrikes se riciklimit te baterive te plumbit, xeherorit me permbajtje plumbi dhe prodhimi i aliazheve te plumbit, arredim te zyrave dhe laboratorit.

Konkretish me poshte po japim te detajuar procesin teknologjik.

Plumbi është metal i riciklueshëm dhe në përgjithësi përdoret për të bërë një bateri të re ose në aplikime të tjera. Në mënyrë që të riciklojmë, ne duhet së pari të veçojmë baterinë në pjesë dhe pastaj ta bëjmë gati ta përdorur përsëri. Bateria e përdorur së pari pritet dhe pjesët e saj nxirren jashtë, më vonë plumbi i nxjerrë dërgohet në furre për shkrirje dhe pasi plumbi është rikuperuar, është rafinuar deri në 99.9% për t'u ripërdorur. Pjesa e dytë e plumbit që mbetet është përsëri metal me përqindje më të ulët, ky plumb mund të përdoret për aplikacione si polet e baterisë etj ose mund të rishkrihet përsëri për tu pasuruar.

Fabrika është projektuar në një mënyrë të tillë që të gjitha përbërësit e baterive të plumbit të harxhuar të riciklohen në një mënyrë në mënyrë që ato të mund të ripërdoren plotësisht dhe të ketë një sasi minimale si mbetje (skrap). Ajo ka gjithashtu fleksibilitet në rikuperimin e plumbit nga xeherori. Kjo fabrikë gjithashtu mund të prodhojë lidhje (aliazhe) të ndryshme të plumbit sipas specifikimeve të klientit.

Përdorimet e metalit të Plumbit dhe aliazheve të tij:

Metali i plumbit ka shumë përdorime në Aplikime Industriale, disa prej tyre janë si më poshtë:

- Bateritë për ruajtje,

- Mbulimi mbi kabllot e tensionit të lartë,
- Tubat e plumbit,
- Veshjeve anti-korrozive,
- Reaktorët bërthamorë,
- Industrinë ushtarake
- Pajisjet e kontrollit të zhurmës dhe vibrimeve,
- Pregatitjen e ngjyrave,
- Kimikate.

Kërkesat e procesit:

Qëllimi i impiantit është të ricikloje baterite e përdorura të makinave apo përpunojë koncentratin e plumbit në mënyrë që të mund të ripërdoret apo përdoret në formën e lëndës së parë për produktin e ri.

Hyrje per produktin:

Plumbi është një nga metalet më të rëndësishme në botë. Përdorimi i tij ka siguruar pozicionin e katërt në mesin e metaleve me ngjyra. Tre të parët janë bakri, alumini dhe zinku. Nga konsumimi i plumbit, rreth 75% e tij kthehet në formën e skrapit.

Plumbi është metal shumë me shkëlqim që ka 11.3gm / cc. Për shkak të vetisë së tij shumë të veçantë të absorbimit të neutroneve, ai gjen përdorim në reaktorët bërthamorë. Plumbi është rezistent ndaj gërryerjeve të acidit sulfurik dhe shumicës së kripërave. Plumb bashkë me oksidet e tij në gjendje të formuar ruan energjinë elektrike në gjendje kimike, e cila në kthimin e reaksionit kimik gjeneron Energjinë Elektrike. Kjo veti ka qenë e dobishme në prodhimin e baterive me acid plumbi. Është e njohur qysh prej shekujsh se pigmente të prodhuara nga Oksidet e Plumbit kanë vetitë e shkëlqyera të rezistencës ndaj gerryerjeve, si dhe reflektim të shkëlqyeshëm të ngjyrave. Kromatet e plumbit të klasave të ndryshme janë këto shembuj.

Përbërja kimike e Produktit:

Plumbi (99,97% pastërti) do të ketë përbërje kimike që konfirmojnë ISO3717: 1977 e cila ka nivelin e papastërtisë si më poshtë:

- Bakri 0,005% Maks.
- Antinom 0,003% Maks.
- Bismut 0.020 Max.
- Arseniku 0.0002% Maks.
- Zink 0,005% Maks.

Këto përqindje mund të konfirmohen edhe nga testet laboratorike. Lidhjet e tjera me bazë plumbi do të kenë përbërjen sipas kërkesës së konsumatorit.

Impianti dhe makinerite

- Makina e Prerjes së baterisë me shtojcën e kullimit të acidit
- Sistemi i neutralizimit të acidit.
- Furre rrotulluese me sistemin e kontrollit të ndotjes së ajrit për thithjen e gazit të tymit
- Sistemi i rafinimit per plumb me përqindje maksimale
- Sistemi i kontrollit të ndotjes së ajrit për sistemin e rafinimit në hyrje/ daljes të furrës rrotulluese.
- Sistemi i Ngarkimit Automatik të Furrave.

Pajisje të tjera të përfshira janë:

- Peshore
- Laboratori
- Mjetet për riparime dhe mirëmbajtje,
- Ashensor pirun dhe ngritje elektrike për lëvizjen e materialeve.

Riparimet (mirëmbajtja), pjesët e këmbimit

Proçesi në përgjithësi nuk ka demtime dhe konsumim. Gjithësesi kostojo e mirëmbajtjes kushton më pak se 1% të kostos totale për muaj.

Materialet e konsumit

Ai përfshin veshjet e sigurisë, koston e zyrës dhe materialet e përgjithshme të konsumit, si dhe kimikate laboratorike etj.



DIAGRAMA E PROCESIT TE PRERJES SE BATERIVE



DIAGRAMA E PROCESIT TE FURRES RROTULLUESE

Impianti i kontrollit/pastrimit të ajrit të ndotur:

Gjatë shkrirjes, prodhohen vëllime të mëdha të gazrave, që përmbajnë sasi të konsiderueshme të pluhurit. Pas lëshimit të materialit të shkrirë, gazrat ftohen nga rreth 900° C deri në rreth 100° C duke përdorur ajrin dhe/ose ftohjen e ujit dhe kalojnë në një depozitë ku grumbullohet pluhuri dhe përfundimisht kthehet në Furrën Rrotulluese. Gazet më pas lëshohen në atmosferë. Gjatë përpunimit të një ton plumbi, duhet të pastrohen 100 ton ajër në këtë mënyrë. Sa i përket ndotjes së ajrit, gjatë shkrirjes do të ketë gazra, pluhur dhe blozë që vijnë nga furra rrotulluese dhe kazanët e rafinimit. Kjo është e gjitha thithet në sistemin e kontrollit të ndotjes së ajrit. Faza e parë ka një koleksionist pluhuri, ku grimcat më të mëdha të ngurta hiqen. Nga kolektori i pluhurit, gazrat dërgohen në një kullë ftohëse për të zvogëluar temperaturën e përzierjes dhe për të ndarë grimcat e mëdha. Kjo pastaj çohet në një ciklon, i cili ndan grimcat e ngurta. Gazi pastaj dërgohet në shtëpinë e qeseve, e cila pastaj kalon nëpër gazra përmes filtrave të qeseve, të cilat heqin grimcat e ngurta aq të vogla sa 10 mikronë. Të gjitha grimcat e ngurta të larguara deri tani janë dërguar në njësinë e ngarkimit të furrave rrotulluese. Hapi i fundit është një pastrues me lagështi, ku avull i ujit ndan rreth 80% të grimcave të mbetura të ngurta, dhe në të njëjtën kohë thith gazra të caktuara, veçanërisht SO2 nga përzierja e gazit. Ajri i pastruar dërgohet në atmosferë përmes oxhakut. Pajisjet e mëposhtme përdoren për të udhëzuar gazrat e zjarrit në oxhak kështu që këto mund të lëshohen në atmosferë në mënyrë eko-miqësore.

Blloku i fundit

Drejton gazrat në dhomën e sedimenteve. Është në formë të rrumbullakët ose katrore e cila përbehet nga tulla të forta për të minimizuar shpërndarjen e nxehtësisë. Duhet të jetë lehtësisht i rrëshqitshëm në mënyrë që të ketë akses për pastrim në rast të vendosjes së materialit të shkrirë në rrugën drejt dhomës së vendosjes. Zhvendosja mund të jetë mekanike/elektrike.

Dhoma e sedimenteve

Eshtë një ndarje e bërë me tulla të Kuqe të veshur me tulla zjarrduruese për të kaluar gazrat e gripit të cilat japin stabilitet të temperaturës dhe reduktojnë rrezatimin e furrës. Ajo ngadalëson shpejtësinë e gazrave dhe grimcat e mëdha bien për shkak të gravitetit. Efikasiteti i tij varet nga koha e qëndrimit me shpejtësinë e uljes së rrymës së gazit. Zvogëlon shpejtësinë e gazrave të zjarrit, kjo ndihmon në heqjen e grimcave më të mëdha (SPM) me ndihmën e forcës gravitacionale, e cila i jep kohë qëndrimit gazit, më shumë ulje të SPM, ul shpejtësinë dhe zvogëlon volumin e gazrave të zjarrit.

Avantazhet e Dhomës së sedimenteve:

- Nuk ka kosto të dukshme të energjisë por kosto shumë të ulët të energjisë për ventilatorin I/D.
- Asnjë pjesë nuk është në lëvizje, me kosto praktike shumë të ulët të mirëmbajtjes
- Besueshmëri e shkëlqyeshme
- Rënie e menjëhershmë të presionit

- Sigurimi i ftohjes së gazrave të zjarrit
- Kufizimi i temperaturës varet nga lloji i materialit ndërtimor
- Sipërfaqja dhe lartësia e dhomës varet nga temperatura që duhet të ulet, rënia e SPM-së e kërkuar dhe rënie të presionit minimal
- Pajisja për rikuperimin e nxehtësisë mund të instalohet ose të lidhet me të
të copave të suvasë. Mundësit për të prekur zonën dhe për tu goditur nga tërmetet me intensitet të lartë janë të vogla. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

Shqipëria është një vend ballkanik me një aktivitet sizmik historikisht të lartë dhe një rajon i ndërlikuar nga pikëpamja tektonike. Vendi karakterizohet nga aktiviteti mikrosizmik, pra nga një numër i madh i tërmeteve të vogla (madhësia M <5.5), rrallë nga tërmete mesatare (magnitude 5,5-5,9) dhe shumë rrallë nga tërmete të mëdhenj (madhësia M> 6.5). Shumica e tërmeteve të fortë në Shqipëri kanë ndodhur përgjatë tre brezave të mirë-përcaktuar sizmik.



Këta breza sizmik janë përcaktuar si më poshtë.

- Brezi bregdetar Adriatiko - Jonik me shtrirje veriperëndim-juglindje që përkon me kufirin midis pllakës Europiane dhe mikro-pllakës së Adrias.
- Brezi Peshkopi-Korçë, në pjesën lindore të vendit me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi tërthor Elbasan-Dibër-Tetovë, me shtrirje jugperëndim-verilindje përgjatë dy brezave të mëparshëm.

- **Përshkrimi i gjeologjisë dhe tokës**

Bazuar në Hartën Gjeologo-Inxhinierike për Qarkun Elbasan, të SHGJSH, shkëmbinjtë mesatar zënë pjesën më të madhe të territorit. Ato janë flishe ritmike me shtresë të hollë argjilo-alevrolito-ranorë, argjilite masive dhe mollasa argjilore. Në zonën me lartësi më të madhe ka shkëmbinj të fortë gëlqeror, gëlqerorë siliçore dhe magmatike intruzive, ultrabazike. Përgjatë Lumit Shkumbin kemi dhera me kohezion me suargjila të vendosura mbi zhavorret (Szh) ose mbi materialin copzor deluvial (De). Në veri perëndim të qytetit të Elbasanit ka shkëmbinj të dobët me depozitime të vjetra kuaternare të padiogjenizuara plotësisht.

- **Topografia**

Territori i Bashkisë Elbasan ka përgjithsisht reliev kodrinor-fushor (në pjesën perëndimore dhe qëndrore) dhe pjesërisht kodrinor-malor (në verilindje dhe juglindje). Zona fushore ndodhet përgjatë luginave të lumenjve kryesorë, ku sipërfaqen më të madhe e ka ajo e Lumit Shkumbin (fusha e Elbasanit dhe e Bradasheshit). Lartësia maksimale në këtë zonë arrin 70-128 metra mbi nivelin e detit.

Niveli i pjerrësive në Bashkinë Elbasan fillon nga 7.13% deri në 100%. Zona fushore në pjesën qendrore, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët që varion nga 0 deri në 16.93%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi që shkojnë deri në 49.91%. Megjithatë, në zonat kodrinore hasim edhe pjerrësi që shkojnë deri në 60.61%, por kjo më shumë haset në zonat e majave të kodrave dhe kurrizive kodrinore. Në shpatet e thepisura të maleve që ndodhen në pjesën juglindore pjerrësia varion 87.36% mbi 100%, (pra mbi 45°).

- **Përshkrimi i ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit**

Ne brendesi te territorit ku do te zhvillohet aktiviteti nuk kemi prani te burimeve nentokesore dhe siperfaqesore. Distanca e objektit nga lumi Shkumbin qe kalon perbri Kombinatit Metalurgji Elbasan, ne pjesen jugore te tij, eshte 1.35 km.



Distanca nga lumi Shkumbin

- **Ujërat nëntokësorë**

Si rezultat i përfshirjes së kësaj zone në basenin e Shkumbinit, ajo rezulton e pasur me ujëra nëntokësorë. Kjo është kushtëzuar nga përhapja e shkëmbinjve me veti të mira dhe mesatare grumbulluese (p.sh. zhavorre), kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1000 mm në vit, nga rrjeti hidrik (lumi Shkumbin, përroi i Kushës) dhe nga relievi fushor me pjerrësi të vogël drejt perëndimit.

Edhe përsa i përket ujërave nëntoksorë (akuiferë), kjo bashki ka një rrjet mjaft të pasur, të cilët (siç viher re në figurën më poshtë) shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike dhe si rrjedhojë kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës. Në Bashkinë e Elbasanit mbizotërojnë shkëmbinj kompakt sedimentar me përbërje flishore, pa porozite të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh.

5.2 PËRSHKRIMI I BIODIVERSITETI NË ZONËN E PROJEKTIT

- **Përshkrimi i habitave kryesore**

Projekti i propozuar per Fabriken e riciklimit t ebaterive te plumbit ndodhet teresisht brenda zones industriale te kombinatit Metalurgjik Elbasan, zone e cila eshte e rrethuar dhe ne te nuk kemi zhvillimin e habitave te ndryshem, te vetmet habitate qe mund te permendim jane ato te zogjve migratore, por duke qene zone me ndotje te larte edhe keto habitate nuk i afrohen, pasi nuk kane kushtet e nevojshme per shtegtimin e tyre.

- **Përshkrimi i vegjetacionit**

Objekti ku do te zhvillohet aktiviteti i fabrikes se riciklimit te baterive te plumbit, xeherorit me permbajtje plumbi dhe prodhimit te aliazheve te plumbit ndodhet brenda territorit te Kombinatit Metalurgjik Elbasan dhe eshte nje zone e varfer me floren siperfaqesore. Ajo perbehet kryesisht nga shkurre, barsihte, plepi, xunkthi, kumbulla, etj.

Ndersa ne zonat perreth Kombinatit Metalurgjik Elbasan, kryesisht ne Njesine Administrative Bradashesh dhe Paper, bimët natyrore të zonës përfaqësohen nga lloje të ndryshme shkurresh. Ndër bimët kryesore që kultivohen janë: gruri, misri, duhani, jonxha, perimet. Në pjesën kodrinore kultivohet ulliri, fiku, rrushi, qershia, pjeshka, shega, hurma, etj.



Vegjetacioni i zonës së projektit

- **Përshkrimi i faunës**

Sikurse permendem edhe me lart, ne brendesi te territorit te Kombinatit Metalurgjik Elbasan nuk kemi zhvillim te faunes, pasi eshte zone me potencial te larte ndotes, gjithashtu duke mos patur habitanin e nevojshem dhe zhvillimin e kulturave bujqesore te ndryshme, eshte e pamundur zhvillimi i faunes ne kete zone.

5.3 PËRSHKRIM I KARAKTERISTIKAVE SOCIALE TË ZONËS SË PROJEKTIT

- **Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zhvillohet projekti**

Projekti i propozuar ndodhet në ish Kombinatin Metalurgjik Elbasan, në territorin e Bashkisë Elbasan, Njësia Administrative Bradashesh.

- **Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike në zonën ku do të zbatohet projekti**

Në zonën ku do te zbatohet projekti nuk kemi popullsi rezidente, pasi eshte zone teresisht industriale, te karakterit industry e rende.

Aktivitetet ekonomike kryesore qe zhvillohen jane:

- Industria e perpunimit te metaleve me ngjyre dhe pa ngjyre
- Menaxhimi i mbetjeve te skrapeve, hekurishteve, metaleve etj
- Shperndarja dhe magazinimi i karburanteve
- Shkrirja e mineraleve
- Industria e perpunimit te polisterolit
- Industria e magazinimit dhe prodhimit te kimikateve
- Menaxhimi i mbetjeve nga industria perpunuese
- Etj
- Perdorimi i tokes ne zonen e projektit

E gjithe siperfaqja e ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan, eshte e shfrytezuar per perdorim industrial, ku jane ndertuar godina te ndryshme te karakterit industrial, per fushat dhe aktivitetet e lartpermendura.

Ne kete zone nuk kemi perdorim te tokes, per zhvillime infrastukturore te karakterit urban, dhe gjithashtu nuk kemi as perdorim te tokes per zhvillimin e kulturave te ndryshme bujqesore, pasi ndotja eshte e larte dhe vete zona ka karekterin industrial.

6 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

6.1 METODOLOGJIA E IDENTIFIKIMIT TË NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Për parashikimin e ndikimeve në mjedis grupi hartues i raportit te thelluar te VNM-se, shoqeria "LORENZO & CO" është bazuar në:

- Krijimin e një baze të dhënash me përgjigjet mbi pyetjet lidhur me problematikat mjedisore dhe analizimin e tyre
- Analizimin e zbatimit të projektit në fushë
- Informimin dhe konsultime me komunitetin dhe aktorët e tjerë të interesuar

Tematika e pyetjeve të cilat formulohen në mënyrë që të identifikohen ndikimet dhe vlerësimi i këtij projekti në mjedis janë:

- A ka përputhshmëri të plotë projekti me ligjet dhe rregulloret përkatëse?
- A do të ndikohen nga projekti kushtet sociale-ekonomike të komunitetit pritës dhe shëndeti i banorëve?
- A do të kenë ndonjë ndikim afatgjatë ose të përhershëm në sistemet ekologjike ose pasuritë natyrore të lokalitetit apo ato që paraqesin interes kombëtar ose rajonal?
- Do të ndikohen komponentët e ndryshëm te ekosistemit të zonës?

6.2 NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS

Ndikimet e mundshme ne mjedis do te ndahen ne dy faza: i. Faza e restaurimit te objektit dhe ii. Faza e funksionimit te instalimit.

Vlerësimi i rëndësisë të ndikimeve në mjedis të aktivitetit të restaurimit dhe funksionimit te fabrikes se riciklimit te baterive te plumbit

Faza	Receptori i ndikimit	Shtrirje fizike madhësia	Kohëzgjatja	Kthyeshmëria	Rëndësia si shumatore e shtrirjes, kohëzgjatja dhe kthyeshmëria	Nevojat për masat zbutëse
TOKA						
Restaurim	Gjenerim dherash dhe masë sterile	Lokale	Përkohshëm	Po	I rëndësishëm	Nevojitet sistemimi i i dherave dhe sterileve te gjeneruara nga restaurimi i objektit, hapja e vaskave te trajtimit te ujrave dhe sistemimin e jashtem te territorit te objektit
	Ndikim në gjenerimin e mbetjeve të	Lokale	perkohshem	Po	I pa rëndësishëm	Vendosja e kontenierëve për

	amballazhit					grumbullimin e mbetjeve
Funksionimi	Gjerimi i plastikes nga copetimi i baterive	lokale	gjate gjithe periudhes se funksionim it te instalimit	po (rikuperim dhe riciklim)	i rendesishem	Mbetjet plastike te gjeneruara nga grirja e baterive, do te rikuperiohen, grihen (granule) dhe do ti jepen subjekteve te riciklimit te mbetjeve per trajtimin dhe riciklimin e metejshem te tyre
	gjenerimi i skorjeve nga furrat	lokale	gjate gjithe periudhes se funksionim it te instalimit	po (rikuperim dhe riperdorim)	i rendesishem	Mbetjet e skorjeve te plumbit qe gjenerohen nga furrat e riciklimit te baterive, rikuperohen dhe riperdoren perserin ne procesin e riciklimit te baterive te plumbit, duke e derguar rendimentin e riciklimit ne 99.9 %

	Gjenerimi i mbetjeve te gazta, dhe mbetjeve nga oxhaku	lokale	gjate gjithe periudhes se funksionim it te instalimit	po (rikuperim dhe riciklim	i rendesishem	mbetjet e gjeneruara nga trajtimi i gazeve, nderimi i filtrave, pastrimi i oxhakut, do te rikuperohen dhe magazinohen ne fucia te mbylluara hermetikisht dhe do te realizohet asgjesimi perfundimtar i tyre nga subjekte te licencuara
	mbetje ujore	lokale	gjate gjithe periudhes se funksionim it te instalimit	po (grumbullim dhe trajtim)	i rendesishem	mbetjet qe do te gjenerohen nga trajtimi i ujrave teknologjike do te riuperohen dhe magazinohen ne depozita/fuci a te padepertuesh me dhe me pas do te behet trajtimi i tyre nga subjekte te licencuar
BIODIVERSITETI						
restaurim	Shqetësim i faunës së zonës	Lokale	Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Ne zonen ku ndodhet objekti nuk kemi faune (shpende dhe kafshe) qe mund te shqetesohet nga punimet restauruese
funksionimi	Shqetësim i	Lokale	Përkoshëm	Po	I pa	Instalimet

	faunës së zonës				rëndësishëm	ndodhen brenda objektit dhe jane te pajisur me pajisje mbrojtese ndaj zhurmes, duke mos patur ndikim ne faunen e zones perreth, edhe pse eshte zone e varfer me gjallesa
UJERAT						
Restaurim	Gjenerimi i ujrave teknlogjike	Lokale	I Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	gjate fazes se restaurimit te objektit, nuk kemi gjenerim te ujrave teknologjike pasi nuk do te kete procese te perdorimit te ujit
funksionimi	Gjenerimi i ujrave teknlogjike	Lokale	gjate gjithe periudhes se funksionimit te instalimit	po (grumbullim dhe trajtim)	I rendesishem	Gjate procesit te copetimit te baterive te plumbit, kemi gjenerim te acidi te baterive i cili grumbullohet dhe dergohet ne depoziten e acidit, ku behet precipitimi i plumbit dhe me pas trajtimi i acidit, me qellim neutralizimin e pH dhe mpiksen e llumrave. Precipitati i plumbit grumbullohet dhe riperdoret

						perseri ne procesin e riciklimit, ndersa llumrat e ricikluara, grumbullohen dhe depozitohen ne fucia te mbyllura hermetikisht, me qellim trajtimin dhe asgjesimin e metejshem te tyre
AJER						
Restaurim	Gjenerim i pluhurave	Lokale	I përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Gjate fazes se restaurimit te objektit, kryesisht heqjes se suvatimeve dhe sistemimeve te brendshme dhe te jashtme, kemi gjenerim te grimcave te pluhurit, te cilat jane te kontrolluesh me, pasi punimet do te kryhen brenda standarteve, duke rrethuar kantierin e punimeve me rrjete me qellim kapjen e grimcave te pluhurit
Funksionimi	Gjenerimi gazrave	Lokale	I përkoshëm	Po	I rëndësishëm	Nga proceset e shkrirjes se plumbit ne furre kemi gjenerim te gazrave te demshem ne atmosfere, ku

						shoqeria do te marre te gjitha masat e nevojshme per kapjen dhe trajtimin e tyre. Fillimisht behet e mundur ulja e temperatures se gazeve me qellim eleminimin e gazeve sere, me pas nepermjet impiatit te trajtimit te gazeve behet e mundur reduktimi i shkarkimeve ne ajer.

- **Lloji i ndikimeve të identifikuara**

Për vlerësimin e impaktit në mjedis dhe në atë social, u përdor një shkallë vlerësimi me 5 gradë (për të vlerësuar madhësinë e impaktit) si dhe kombinimi me kohëzgjatjen e këtij impakti i vlerësuar me 3 grade (shih shkallën e vlerësimit në vijim). Për lehtësi vizuale madhësia e impaktit të vlerësuar ndryshon sipas shkallës me efektin e ngjyrave të zgjedhura.

- Shkalla e impaktit

+++++	Akiviteti ka impakt të lartë pozitiv
++++	Aktiviteti ka impakt pozitiv mbi mesataren
+++	Aktiviteti ka impakt mesatar pozitiv
++	Aktiviteti ka impakt të ulët pozitiv
+	Aktiviteti ka impakt shumë të ulët pozitiv
0	Aktiviteti nuk ka impakt (neutral)
-	Aktiviteti ka impakt shumë të ulët negativ
--	Aktiviteti ka impakt të ulët negativ
---	Aktiviteti ka impakt mesatar negativ
----	Aktiviteti ka impakt negative mbi mesatara
-----	Aktiviteti ka impakt të lartë negativ

- Kohezgjatja e impaktit

1	Impakti eshte afatshkurter
2	Impakti eshte afatmesem
3	Impakti eshte afatgjate

Ne tabelen e mesiperme numrat 1, 2, 3 tregojne afatet kohore

Impaktet potenciale negative pa masa zbutëse

Pritësi i Ndikimit	Burimi i Impaktit	Kohëzgjatja Shtrirja fizike, Madhësia	Kthyeshmëria ne gjendjen fillestare	Shkalla e ndikimit	Nevojat për masat zbutëse
Toka					
Përdorimi i Tokës	Restaurimi i objektit ekzistues	2	+	--	Përdorimi i pajisjeve të përshtatshme teknollogjike. Lagia e terrenit.
Kontaminimi i tokës	Jo	1	+	-	Plan veprimi
Ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit	Karpenteri Betonim Vibrim Montim	1	--	--	Plan Rehabilitimi Standartet e punimeve.
Biodiversiteti					
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Sistemi I terrenit. Gërmimet. Emetimet e gazrave dhe pluhrave. Rrjedhjet.	1	--	--	Zbatimi i rregullores. Kushte teknike optimale te mjeteve të punës. Parandalimi i ndotjes
Fauna					
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Sistemi I terrenit. Gërmimet. Emetimet e gazrave dhe pluhrave. Rrjedhjet. Restuarumi	1	---	--	Zbatimi i rregullores. Kushte teknike optimale te mjeteve të punës. Parandalimi i ndotjes.
Cilësia e ajrit					
Rritje e emetimeve të CO2, CO, NOx, SO2, LN, HC(VOC),	Rritje të emetimeve në ajër nga djegia e diesel që përdoret nga kamionët burim por edhe nga automjetet e tjera shoqëruese	1	-	---	Përdorimi i mbulesave tek kamionët dhe vend depozitimi. Transporti të kryhet në oraret e trafikut të lire. Karburanti të jetë cilsor. Kontrolli periodik i mjeteve të punës për shkarkimet. Përdorimi efiçent i mjeteve të punës.
Cilësia e ujërave					
Ujërave	Aktiviteti i	1	--	--	Pastrimin e

sipërfaqësore	**restaurimit, sistemimit.**				**mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndësh ndotëse në mjedis**
Ujërat nëntokësore	**Aktiviteti i restaurimit, sistemimit.**	**1**	--	--	**Pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndësh ndotëse në mjedis**
Hidrologjia					
Sistemi i kullim/shkarki mit gjendja hidrologjike, dekantimi, erozioni	**Sistemi i terrenit. Gërmimet. Aktiviteti i restaurimit.**	**1**	--	--	**Sistemi kanaleve kulluese. Muret mbajtëse.**
Përmbytjet	**JO**	**JO**	**JO**	**JO**	**Terreni ka pendence & ujrat e larta kullojne në kanalin kryesor drenazhues.**
Mbetjet					
Shtim i mbetjeve urbane	**Shtimi mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në këtë projekt**	**1**	-	-	**Vënd grumbullime të diferencuara.**
Mbetjet inerte	**Sistemi i terrenit. Gërmimet. Aktiviteti i restauritmi.**	**1**	--	--	**Vend depozitim brenda kantierit. Transport ne vendepozitimin e caktuar nga Njesia Administrative Vendore Ripërdorim**
Peizazhi					
Ndryshimi i peizazhit	**Gjat fazes së punimeve & pas përfundimit ku merr peisazhin përfundimtar**	**2**	-	++	**Duke u bazuar në projektin peisazhi përfundimtar do të rris vlerat e zonës.**
Monumentet e natyrës dhe të kulturës /Zonat e mbrojtura	**JO**	**JO**	-	++	**Duke u bazuar në projektin përfundimtar do të kemi rritje të vlerave e zonës.**
Zhurmat					
Rritje e nivelit të zhurmave	**Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve dhe kamionëve**	**1**	--	--	**Mjete me kolaudim optimal. Punime gjat orëve të përshtatshme.**

	burim				
Trafiku					
Trafiku	**Rritje potenciale e trafikut nga lëvizja e kamionëve dhe mjeteve gjatë implementimit të projektit**	**1**	**-**	**-**	**Transporti do të kryhet gjat orëve qe shamang pikun e trafikut & në ato zona që shmang sa me shumë vendet e banuara**
Ndikimi Social					
Ndikimi Sociale	**Ndikime potenciale negative në komunitet që lidhen me impaktet negative të evidentuara**	**1**	**-**	**--**	**Do të kërkohet mirkuptimi i gjithë banorve për zhvillimin optimal të projektit. Banorë të zonës do përfshihen në projekt.**

7 NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT

Projekti i propozuar për restaurimin dhe montimin e fabrikës se riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit, nuk ka ndikim ne mjediset nderkufiatare, ai ndodhet teresisht ne zonen industriale te ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan, ne nje distanstance te konsiderueshme nga shtetet fqinje.

8 NDIKIMET POZITIVE NË MJEDISIN E ZONËS SË PROJEKTIT

Ndikimet pozitive në zonën e projektit evidentohen si në mjedis dhe në aspektin social.

Ndikimi	Shkalla e Impaktit
Transparencë e plotë mbi implementimin e këtij projekti, me aktorët e interesuar dhe zhvilluesve të këtij projekti nëpërmjet një sërë takimesh dhe konsultimesh dhe diskutimesh të hapura për të gjithë.	++++
Implementimi i teknologjise bashkohore me ndikim te ulet ne mjedis, si dhe teknologji e cila mundeson reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve te baterive te plumbit qe gjenerohen ne territorin e Republikes se Shqiperise	++++
Punësim i përkohshëm punonjësve në këtë projekt gjate fazes se restaurimit dhe montimit te fabrikes, si dhe punesim afatgjate i specialisteve te fushes dhe banoreve te zones gjate fazes se funksionimit te fabrikes se riciklimit te baterive te plumbit.	+++
Shërbime shtesë të ofruara nga komuniteti në ndihmë të plotësimit të kërkesave të punonjësve si dhe nënkontraktorëve të tjerë që marrin	++++

pjesë në zbatimin e këtij projekti.	
Rritje të ardhurash nga taksat për çdo shërbim të ofruar	+++++
Përmirësimi i peisazhit të zones edhe pse ndodhet ne zone industriale, kemi te bejme me rikonstruksion te objektit ekzistues	+++++
Krijimi i ambienteve të reja për shoqerine CCALB Sh.p.k	+++

Të dhëna ndikimeve pozitive

9 MASAT E PROPOZUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së riciklimit dhe impiantit të prodhimit. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku jane te istaluara linja e riciklimit te baterive te plumbit, shkrirjes se mineralit me permbajtje plumbi dhe prodhimin e lingotave te plumbit
Biodiversiteti	
Vegjetacioni **Dëmtim potencial i vegjetacionit**	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve ne ajer nga funksionimi i linjes se riciklimit - prodhimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	Mirembajtja e linjes se riciklimit-prodhimit dhe nderrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi efiçent i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës.

	Pastrimi periodik i linjës së riciklimit - prodhimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Përdorimi i lëndës djegëse ne mjetet e transportit me përmbajtje squfuri të ulët sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar mjedisor (përmbajtja e S < 1 %);
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe impiantit te trajtimit te ujrave teknologjike te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaskat e dekantimit të përbashkëta dhe riciklimi, riperdorim i ujrave. Trajtimi i ujrave teknologjike sipas rastit dhe shkarkimin e tyre ne mjediset ujore pritese brenda normave te lejuara.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve industrial dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga impianti, nga kompani te licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim ne maksimum i mbetjeve te gjeneruara nga linja e riciklimit te baterive te plumbit. Monitorim dhe inspektim i vazhduar në vendin e depozitimit. Në rast nevoje, të merren veprime të posaçme
Ujërat e Ndotura Urbane	Perdorimi i ujit eshte me cikel te mbyllur, duke riqarkulluar te njejten sasi uji per ftohjen e furrave. Maksimizimi i perdorimit te ujit. Trajtimi i ujrave te ndotura teknologjike Rikuperimi i sendimenteve te plumbit dhe riperdorimi i tyre ne procesin e shkrirjes
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise,

të automjeteve	referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

10 PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për Restaurimin dhe montimin e fabrikës se riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit, është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Në përputhje me karakteristikat e implementimit dhe të Restaurimin dhe montimin e fabrikës se riciklimit të baterive të plumbit, xeherorëve me përmbajtje të plumbit dhe prodhimin e aliazheve të ndryshme të plumbit dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Monitorimi i parametrave mjedisore

Nr.	**Monitorimi**	**Parametrat që do të monitorohen**	**Periudha kohore**	**Frekuenca**	**Përgjegjësia**
1	**Cilësia e Ajrit**	PM10, SO2, NOx, CO , CO2 ,HC	Nga fillimi i projektit deri ne perfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor Hartuesit e Raportit te Thelluar te VNM-se
2	**Emetimi i zhurmave**	Niveli i zhurmave në dB	Nga fillimi i projektit deri ne perfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor Hartuesit e Raportit te Thelluar te VNM-se
3	**Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës**	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i projektit deri ne perfundimin e tij	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë
4	**Avari apo**		Nga fillimi i	Çdo 3 muaj	Oficeri i

	defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit	Regjistrohen, raportohen	projektit deri ne perfundimin e tij		Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
5	**Monitorim i zbatimit të kushteve të Deklarates Mjedisore**	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri ne perfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit & Inspektoriati përkatës

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket monitorimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

11 PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR

- **PMM-ja për një komponent Projekti apo një nënprojekt do të përmbajë:**

- Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë funksionimit (përfshirë mirëmbajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasoja.
- Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojën, koston dhe nivelet e lejuara ligjore.
- Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte që ka mundësi të dalin në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet masave mbrojtëse gjatë funksionimit, apo metoda të tjera, kostot e mundshme, implikimet për përfundimet e projektit, etj.
- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); përgjegjësitë institucionale për secilin veprim; dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.
- PMM-ja do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës dhe një Plan Monitorues. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizmit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e specifikuara në miratimin e Deklarates Mjedisore të lëshuar nga AKM-ja.

Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te linjes se prodhimit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikoje në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e linjes se riciklimit - prodhimit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit te linjes se riciklimit - prodhimit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në menyrë të përmbledhur si më poshtë :

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes se riciklimit - prodhimit.
- Mbetjet e ngurta urbane dhe ato industriale që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier te mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte te licencuara.

- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi i mbetjeve te gjeneruara nga riciklimi i baterive te plumbit, shkrirjes se mineralit me permbajtje plumbi dhe prodhimin e lingotave te plumbit.
- Kapja dhe trajtimi i gazeve nepermjete filtrave dhe nderrimi periodik i tyre sipas kapacitetit mbajtes
- Menaxhimi sa me eficent i lendes se pare.
- Mirembajtja nderrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes se tyre.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti per riciklimin e baterive te plumbit, shkrirjes se mineralit me permbajtje plumbi dhe prodhimin e lingotave te plumbit
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
- Rikuperim, Trajtim, Riciklim dhe Riperdorim i ujrave te gjeneruara nga instalimet

12 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

12.1 Të zbatohet projekti i restaurimit dhe perdorimi i fasadave cilësore për të krijuar një pamje estetike integruar me elementë të zonës.

12.2 Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.

12.3 Të shmanget në maksimum perdorimi i gjeneratorit dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.

12.4 Të kryhet lagia e sipërfaqeve të gërmuara dhe me inerte, si dhe të rrugëve komunikuese.

12.5 Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve te dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.

12.6 Të kryhet larja e automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.

12.7 Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.

12.8 Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.

12.9 Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane

12.10 Të vendosen postera sensibilizues per punonjesit dhe banoret per nje mjedis te paster.

12.11 Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Deklaratën Mjedisore që do të miratohet nga AKM.

12.12 Subjekti të respektojë të gjitha masat e percaktuara në këtë raport të thelluar të VNM-së.

12.13 Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.

12.14 Subjekti ndërtues të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset dhe të ndërtohen shkallët e emergjencës.

12.15 Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi.

12.16Si rezulat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimzohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.

12.17Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga restaurimi i objektit ekzistues dhe montimi i instalimit.

12.18Ndikimet do të jenë kryesisht të përkohshme dhe jo të përhershme

12.19Për ndikimet e identifikuara janë propozuar masat përkatëse me qëllim minimizimin dhe eleminimin e këtyre impakteve.

12.20Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eleminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.

12.21Është detyre e Njesise Administrative Vendore gjithashtu monitorojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

12.22Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem që gjatë fazës së restaurimit dhe montimit të instalimeve të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

INVESTITOR: CCALB Sh.p.k

Hartoi Raportin e Vlersimit t Ndikimit në Mjedis

LORENCO & CO